



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 6, Datë 29.12.2016

PËR

MIRATIMIN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT KOMBËTAR SEKTORIAL NË
FUSHËN E TURIZMIT NË RAJONIN E ALPEVE SHQIPTARE

Në mbështetje të neneve 7, 10, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të VKM Nr. 881, datë 14.12.2016 “Për miratimin Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit” si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Nismës për hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Turizmit për Rajonin e Alpeve Shqiptare (PKS Alpet Shqiptare).
2. Dokumenti i plotë i Nismës për hartimin e PKS-së Alpet Shqiptare përmban:
 - a. analizën, e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim ose rishqyrtim të dokumentit të planifikimit;
 - b. kufijtë e territorit të Republikës së Shqipërisë që mbulon dokumenti i planifikimit;
 - c. planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të PKS-së;
 - d. listën e dokumenteve përbërës të PKS-së;
 - e. fushat e ekspertizës që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PKS-në;
3. Fillimin e procedurës për ngritjen e grupit të punës me ekspertë, me qëllim hartimin e Planit Kombëtar Sektorial në fushën e Turizmit për Rajonin e Alpeve Shqiptare.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të drejtojnë punën për hartimin e PKS-së Alpet Shqiptare dhe të kryejnë bashkërendimin, këshillimin dhe organizimin e dëgjësave publike me të gjitha autoritetet e planifikimit dhe palët e interesuara

5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDIRAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



MILVA EKONOMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



SËKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

